

ZGJIMI

BIBLIOTEKA E QYTETIT

“Hajdin Berisha”- Suharekë

DHJETOR, 2025







TABELA E PËRMBAJTJES

FJALA HYRËSE	4
VITI 2025 NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT "HAJDIN BERISHA"	6
- BIBLIOTEKA QË FRYMËZON – PËRMBLEDHJETË AKTIVITETEVE VJETORE - INSTITUCIONET ARSIMORE NË BIBLIOTEKËNTONË - VIZITAT NË SHKOLLAT E KOMUNËS - DITA E BIBLIOTEKËS - PJESËMARRJA NË FESTARIN 2025 - JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË - DONACIONET - KLUBET E LEXIMIT	6 10 14 15 17 18 19 21
"HAJDIN BERISHA" -EMRI QË NDERON BIBLIOTEKËN E QYTETIT	23
KRONIKA E BIBLIOTEKËS: DJE DHE SOT	24
RËNDËSIA E LIBRITË SHTYPUR	26
POEZIA NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT "HAJDIN BERISHA"	27
MIDIS LIBRAVE DHE JETËS	32
KOHA PËR LEXIM	37
ZËRI I LEXUESVE	47
BIBLIOKLUBET	52
STAFI I BIBLIOTEKËS	54

FJALA HYRËSE



Sa herë që takoj njerëz dhe u tregoj se ku punoj, më pyesin me një buzëqeshje kureshtare: "A ka ende njerëz që lexojnë?"

Kjo pyetje gjithmonë më bën të ndalem e të mendoj. Si mund ta përfytyrojmë jetën pa libra, pa lexim, pa fjalën e shkruar që e ndriçon mendjen dhe shpirtin? Sepse, në fund të fundit, po të mos ishte libri, as unë sot nuk do të shkruaja – nuk do të dija shkrim e lexim. Libri është fillimi i gjithçkaje që dimë, e revista jonë është vetëm një përpjekje e vogël për ta mbajtur gjallë librin dhe leximin. Pavarësisht formës së librit, tradicional apo elektronik ne jemi ithtarë të leximit, të lirisë së shprehjes dhe mendimit.

Leximi dhe shkrimi e zhvillon vendin, shoqërinë dhe mendjen e secilit prej nesh. Biblioteka jonë është në shërbim të lexuesve dhe njerëzve që e adhurojnë leximin dhe shkrimin.

Revista "Zgjimi" është titulluar kështu për tri arsye:

1. Ndërgjegjësimi dhe transformimi i lexuesit- ka të bëjë me ndikimin e drejtpërdrejtë të leximit dhe dijes në transformimin intelektual të lexuesit, duke i dhënë revistës një qëllim të lartë dhe frymëzues.
2. Thirrje për veprim - është një thirrje e hapur drejtuar komunitetit për t'u shkëputur nga pasiviteti dhe për t'u kushtuar më shumë librave dhe leximit, duke nxitur angazhimin aktiv.



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë

3. Lidhja me klubin e leximit- ky titull lidhet drejtpërdrejt me emrin e klubit tonë të leximit në bibliotekë, i cili quhet "Zgjimi," duke krijuar kështu një koherencë mes aktiviteteve të brendshme dhe publikimit.

Viti 2025 është viti i suksesit dhe i punës. Ne duke u munduar të mbajmë gjallë librin dhe leximin kemi organizuar aktivitete të ndryshme, jemi përpjekur që të pasurojmë fondin tonë librar dhe mbi të gjitha krijojmë hapësira të reja ku qytetarët mund ta gjejnë veten përballë librit. Ky vit na gjeti më të përkushtuar se kurrë për t'i ofruar qytetit një bibliotekë më dinamike, më bashkëkohore dhe më të afërt.

Ne jemi përballë një sfidë të madhe: internetit. Në kohën e sotme lufta për lexim dhe dije është më e nevojshme se asnjëherë më parë. Dhe, ne përmes klubeve të leximi po bëjmë përpjekje që biblioteka të kthehet në një hapësirë të gjallë takimesh, dialogu dhe krijimtarië — aty ku leximi nuk është vetëm aktivitet individual, por përvojë e përbashkët që lidh brezat dhe ndërthur traditën me inovacionin.

Shumë shpejt, biblioteka jonë do të ketë rrjetin bibliotekar digjital ku secili individ mund të kyqet dhe t'i gjejë librat që i kemi ne. Ky projekt është i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani". Ky është një hap shumë i rëndësishëm sepse e ofron lexuesin më shumë me librin dhe

leximin.

Libri, në çdo formë të tij — qoftë në letër apo në ekran — mbetet burimi më i sigurt i dijes dhe inspirimit. Ne kemi përgjegjësi që ta ruajmë dashurinë për librin, ta përcjellim te gjeneratat e reja dhe ta bëjmë pjesë të pandashme të zhvillimit kulturor e shoqëror, sepse vetëm një shoqëri që lexon, është një shoqëri që ecën përpara.

Në fund i pergjigjem pyetjes të fillimit: po, ka njerez qe lexojne, madje biblioteka i ka 1327 lexues në një vend të vogël siç është Suhareka jonë.

Udhëheqësja e Bibliotekës
Arbenitë Hoxha Ramaj




VITI 2025 NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT "HAJDIN BERISHA"

BIBLIOTEKA QË FRYMËZON – PËRMBLEDHJETË AKTIVITETEVE VJETORE

Gjatë këtij viti, biblioteka ka organizuar një sërë aktivitetesh që kanë pasuruar jetën kulturore të komunitetit dhe kanë forcuar ndërveprimin me lexuesit. Këto aktivitete kanë lënë gjurmë të rëndësishme në historikun e bibliotekës sonë.

Vlen të theksohet se, për herë të parë, në bibliotekën tonë u shënua Dita e Bibliotekës, e cila u karakterizua nga një varg aktivitetesh të larmishme. Përveç kësaj dite, gjatë gjithë vitit u realizuan shumë aktivitete të tjera, ndër të cilat edhe promovime librash me autorë të ndryshëm. Këtë vit në bibliotekën tonë janë promovuar tetë libra:



1. Libri "Sythat e dritëhijeve të jetës" nga autorët Sedat Gashi dhe Miranda Fondaj.

Një vepër që ndërthur reflektime poetike dhe rrëfime personale mbi përvojat njerëzore, dritën dhe hijet e jetës. Autorët sjellin emocione, kujtime dhe mesazhe universale që lexuesin e nxisin të mendojë mbi sfidat dhe bukuritë e jetës së përditshme.



2. Libri "Shpirti më tha" nga autorja Laureta B. Reshani.

Një libër me poezi dhe shënime meditimi, ku autorja i jep zë botës së brendshme të njeriut. Me gjuhë të butë dhe emocionale, vepra eksploron ndjenjat, vetëdijen dhe procesin e rimëkëmbjes shpirtërore.

3. Libri: "Xhemajl Ramaj- Uragan i Lirisë" nga autori Fikret Ramaj.

Monografi kushtuar jetës dhe veprimtarisë së Xhemajl Ramaj, dëshmor i luftës së fundit në Kosovë. Libri dokumenton kontributin e tij, sakrificat dhe rolin që ka luajtur në periudha të rëndësishme historike për vendin.



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë



4. Libri: "Poezi nëpër kohë" i autorit Bajram Zyba.

Libri përmban poezi që prekin dashurinë, kohën dhe kujtesën, tema universale dhe mjaft të gjalla për shoqërinë tonë.





5. Libri: "Nuk na mungon asgjë- Le të shohim qartë" të autorëve Salvatore Signore dhe Ermond Obrazhda.

Libri përshkruan jetën dhe sfidat e jetës të një të verbëri, të vetë autorit Ermond Obrazhda, i cili pavarësisht sfidave vazhdoi jetën dhe nuk u ndal asnjëherë.

6. Libri: "Brerore Lirie"- nga një grup i autorëve të Shoqatës për Art dhe Kulturë "Elena Gjika – Dora D'Istria.


Një antologji letrare që mbledh krijime poetike dhe prozaike të autorëve të ndryshëm. Vepra trajton motive të lirisë, identitetit, kulturës dhe trashëgimisë, duke ofruar shumëllojshmëri stilesh dhe temash brenda një botimi të vetëm.





7. Libri: "Sporti në Therandë gjatë okupimit 1991-1999- nga autori Ruzhdi A. Kuçi

Monografi që përshkruan sakrificat dhe sfidat që i kanë përjetuar dhe përballur klubet e Therandës gjatë okupimit 1991-1999.



8. Libri: "Shpalime Historike" - nga autori Fadil Bytyçi

Artikuj studimorë, kritikë e recensione nga Historia-ilire-arbërore- shqiptare



INSTITUCIONET ARSIMORE NË BIBLIOTEKËNTONË

Përveç promovimeve të librave, gjatë këtij viti biblioteka jonë ka mirëpritur një numër të konsiderueshëm vizitash nga grupe, institucione dhe individë të interesuar për kulturën e leximit. Këto vizita kanë pasuruar aktivitetet tona dhe kanë krijuar hapësira të reja komunikimi me komunitetin.

Gjatë këtij viti, biblioteka ka pritur një numër të madh vizitorësh nga shkollat fillore, të mesme, organizata kulturore, studentë dhe autorë.

Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme janë njoftuar nga afër me fondin e librave, mënyrën e funksionimit të bibliotekës dhe rëndësinë që ka leximi. Shkollat që vizituan bibliotekën ishin:

- Shkolla fillore "Pavarësia" – Shirokë;
- Shkolla fillore "Lidhja e Prizrenit" – Budakovë;
- Shkolla fillore "7 Marsi" – Suharekë;
- Shkolla fillore "Naum Veqilharxhi" – Mohlan;
- Shkolla fillore "Ramë Bllaca" – Bllacë;
- Kopshti "Ora" " – Suharekë;
- Shkolla e Mesme Profesionale IAAP "Abdyl Ramaj" – Suharekë.





MIRË SE VINI NË VENDIN E MENDJEVE MË TË NDRITURA!



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë





MIRË SE VINI NË VENDIN E MENDJEVE MË TË NDRITURA!



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë



ZGJIMI- Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë

Shoqatat kulturore kanë zhvilluar takime dhe aktivitete bashkëpunimi brenda hapësirave të bibliotekës, siç janë bashkëpunimet e vazhdueshme me SHAK "Elena Gjika Dora d'Istria".



Autorët dhe krijuesit si Mazllum Baraliu, Ibish Ahmeti, Gani Pireva, Lulzim Hajdari, Feim Bllaca, Sherif Gashi, SherifeThaqi, Adem Derguti, Fadil Bytyçi e të tjerë kanë prezantuar veprat e tyre dhe kanë dhuruar libra për bibliotekën tonë.

Shkollat e Mesme:

VIZITAT NË SHKOLLAT E KOMUNËS

Biblioteka ka realizuar vizita në disa shkolla të mesme dhe fillore të komunës me qëllim të informimit për bibliotekat e tyre, diskutimin me drejtorët dhe punonjësit, si dhe dakordimin për bashkëpunimet e ardhshme. Gjatë vizitave, u dhurua nga një pako me libra për secilën shkollë, tituj të pranuar si donacion nga Biblioteka Kombëtare "Pjetër Bogdani", me synim pasurimin e fondit librar dhe nxitjen e leximit tek nxënësit.

- Gjimnazi "Jeta e Re";
- Shkolla Profesionale "Abdyl Ramaj";
- Shkolla Teknike "Skënder Luarasi";

Shkollat Fillore:

- "Dëshmorët e Grekocit" – Greikoc;
- "Edith Durham" – Mushtisht;
- "Hasan Prishtina" – Semetisht;
- "Dëshmorët e Tivarit" – Peqan;
- "Kongresi i Manastirit" – Studenqan;
- "Ramë Bllaca" – Bllacë;
- "Dëshmorët e Kombit" – Vraniq;
- "Naum Veqilharxhi" – Mohlan.

Shkollat e vizituara ishin:



DITA E BIBLIOTEKËS

Në këtë vit biblioteka jonë vendosi t'i kushtojë një ditë të veçantë librit dhe leximit, duke i rikujtuar komunitetit vlerën e pashtershme të dijes. Gjithashtu, kjo ditë na sjell kujtime edhe për veprimtarin, me të cilën krenohemi, emrin e të cilit e mban biblioteka jonë "Hajdin Berisha". Prandaj, jo rastesisht kemi zgjedhur ditën e lindjes së tij për të shënuar Ditën e Bibliotekës, e cila do të mbetet festë tradicionale e institucionit tonë.



Në kuadër të kësaj dite, Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" ndau çmime për kontribuesit tanë. Çmimet që kemi ndarë janë një shenjë mirënjohjeje për ata që me përkushtim e dashuri kanë qenë pranë librit dhe bibliotekës. Këta fitues janë shembull frymëzimi për të gjithë lexuesit tanë.



Çmimi i parë është çmimi "Post mortum", i cili i dedikohet veprimtarisë, punës dhe kontributit të Hajdin Berishës dhe iu dhurua familjes së tij.

Çmimi "Veteran i Bibliotekës" i dedikohet Znj. Myrvete Zenelaj, për përkushtimin dhe dashurinë e saj të gjatë ndaj librit dhe bibliotekës.

Çmimin për "Lexuesin e Sallës së Leximit" e meritoi Jeton Kokollari, lexues i dalluar për përkushtimin e tij në hapësirat e bibliotekës sonë.

Çmimin për "Lexuesin në Sektorin e të Rriturve" e mori Elvira Muqa.

Çmimin për "Lexuesin në Sektorin e Fëmijëve" e pranoi Eliza Grulaj.

Çmimin e "Mik i Nderit" e pranoi Z. Mefail Gashi, si shenjë mirënjohjeje për kontributin e Jashtëzakonshëm dhe përkrahjen e madhe ndaj bibliotekës.

Çmimin për "Punë Vullnetare" e mori Loresa Beluli, e cila na ndihmon vazhdimisht në çdo aktivitet.



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë



Në vazhden e aktiviteteve patëm edhe një takim të veçantë me fëmijët e dy kopshteve të qytetit tonë, kopshti "Flutrat" dhe kopshti "Melodia".

Zyrtarja e Bibliotekës, Miradije Rraqi, lexoi dy përralla mjaft të bukura, të cilat fëmijët i dëgjuan me vëmendje dhe u kënaqën shumë, madje edhe bënë pyetje plot kureshtje.

Gjatë kësaj dite të rëndësishme, u organizua edhe debati me temën: "Leximi në epokën e teknologjisë – sfidat dhe mundësitë". Në këtë aktivitet morën pjesë krijues letrarë, shkrimtarë dhe studiues lokalë, të cilët ndanë mendimet e tyre mbi rëndësinë e leximit në kohën kur teknologjia është bërë pjesë e pandashme e jetës sonë. Diskutimi solli ide të vlefshme mbi mënyrat se si libri tradicional dhe teknologjia mund të bashkohen duke ofruar sfida, por edhe mundësi të reja për lexuesin e sotëm.



Gjithashtu, ne patëm nderin të mirëpresim Dr. Festim Rizanaj, asistent profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës dhe hulumtues në Hibrid.info. Ai ndau me ne njohuri dhe përvoja të rëndësishme mbi temën: "Çrregullimi informativ: përhapja e lajmeve të rreme dhe dezinformimi", duke na ofruar shembuj konkretë dhe analiza mbi ndikimin e tyre në shoqëri. Një ligjëratë që na bëri të reflektojmë

më thellë mbi rolin e informacionit të saktë dhe rëndësinë e mendimit kritik.



PJESËMARRJA NË FESTARIN 2025

Festivali i Kulturës dhe Verës, Festari 2025, është festë e rëndësishme kulturore në komunën tonë. Edhe këtë vit, biblioteka mori pjesë në dy aktivitete kryesore:

- Dhuroni librin e lexuar – një iniciativë e bibliotekës ku qytetarët dhuruan 134 libra për fondin tonë librar, duke kontribuar në zgjerimin e mundësive të leximit për shoqërinë.
- Konkursi poetik – i organizuar nga SHAK "Elena Gjika Dora d'Istria", me bibliotekën si nikoqire të poetëve pjesëmarrës.



ZGJIMI- Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë



JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË

Në kuadër të Javës së Bibliotekës, organizuam një aktivitet me lexuesit tanë, ku secili solli librin e tij të preferuar, prezantoi shkurt përmbajtjen dhe lexoi një fragment të veçantë. Fragmentet u shkruan në fleta me ngjyra dhe u vendosën në hapësirat e bibliotekës si simbol i dashurisë për librin.



DONACIONET

Biblioteka e Qytetit vazhdon të zgjerojë fondin librar falë mbështetjes së vazhdueshme nga individë dhe institucione të ndryshme. Gjatë këtij viti, tre donacione të rëndësishme kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e burimeve lexuese për komunitetin tonë.

Në nderim të kujtimit të Hajdin Berishës, nipi i tij, Kushtrim Kuçi së bashku me bashkëshorten, Leotrina Hoxhaj Kuçi, e cila dhuroi libra në vlerë prej 1,065 eurosh. Ky gjest human e pasuron ndjeshëm fondin librar dhe krijon më shumë mundësi për lexuesit tanë. Mirënjohja jonë shkon për këtë mbështetje bujare që ndihmon në fuqizimin e kulturës së leximit në qytetin tonë.



Një tjetër donacion i rëndësishëm është ai i Mefail dhe Astrit Gashit, pronarë të kompanisë Euroing SH.P.K, të cilët i dhuruan bibliotekës rreth 100 libra të rinj. Këto tituj shtesë jo vetëm që e zgjerojnë gamën e literaturës, por edhe përmirësojnë cilësinë e shërbimit për të gjithë vizitorët.

Për më tepër, Biblioteka u pasurua edhe me literaturë të specializuar falë Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim "Xheladin Deda" në Pejë, e cila dhuroi disa libra në alfabetin Braille, të dedikuar për personat e verbër. Ky kontribut ka rëndësi të veçantë sepse nxit përfshirjen dhe siguron që edhe komuniteti i personave me shikim të dëmtuar të ketë qasje më të lehtë në materiale lexuese.



Këto dhurime janë dëshmi e vlerës që komuniteti ia atribuon bibliotekës dhe misionit të saj. Ato forcojnë rolin e bibliotekës si qendër e dijes, kulturës dhe përfshirjes për të gjithë qytetarët.

ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë



KLUBET E LEXIMIT

Në Bibliotekën e Qytetit kemi krijuar klubin e leximit për fëmijët "Bota e leximit" dhe klubin e leximit për të rritur "Zgjimi". Këto klube janë hapësirë e hapur për të gjithë të pasionuarit pas librit, ku promovojmë leximin, ndajmë mendime e përvoja dhe do të krijojmë diskutime të frytshme mbi veprat letrare.

Biblioteka jonë organizon çdo muaj takime me anëtarët e klubeve të leximit.

Ramiz Selimaj







"HAJDIN BERISHA" -EMRI QË NDERON BIBLIOTEKËN E QYTETIT

Hajdini ishte një model intelektual etik, që ndërthurte kompetencën akademike me moral dhe humanizëm. Ishte i qetë në komunikim dhe i gatshëm të ofronte këshilla profesionale pa imponim.

Në vitet '90-ta, në kushte të vështira politike, Hajdini dha një kontribut të qëndrueshëm në jetën shoqërore dhe në proceset e vetëdijesimit politik

të komunitetit. Ishte i njohur për pjesëmarrjen e tij aktive në iniciativat lokale. Punëtor i qetë, pa bujë, dhe ndërtonte ura bashkëpunimi aty ku jetonte.

Kontributi i theksueshëm i tij si ekspert ndërtimtarie u shpreh sidomos në vitin 1994 pas vërshimeve të ndodhura në qytetin e Therandës. Ai kontribuoi edhe në nisma dhe aktivitete të tjera të shoqërisë që synonin ruajtjen e vlerave kombëtare gjatë represionit serb të viteve '90.

Hajdini krijonte hapësira për dialogë dhe nxiste pjesëmarrjen qytetare që bazohet në vlera të mirëfillta. Autoriteti i tij moral dhe profesional ndikonte dukshëm në proceset politike të atyre viteve. Përkushtimi i tij profesional dhe ndershmëria e tij personale e bënë autoritetin e tij të qëndrueshëm.

Ai dinte të artikulonte qëndrime të matura e të balancuara, e kjo e bënte të respektueshëm në komunitet. Qëllim kishte sidomos ruajtjen e arsimit dhe mbajtjen e dinjitetit njerëzor për të forcuar bashkëpunimin e komunitetit.

Figura e Hajdinit është e ngulitur thellë në kujtesën kolektive: i qetë në sjellje, i fortë në parime dhe i përkushtuar për të mirën e përgjithshme. Andaj biblioteka e qytetit të Therandës me të drejtë e mban emrin e tij Hajdin Berisha.

Prof. Asoc. Dr. Ruzhdi A. Kuçi



KRONIKA E BIBLIOTEKËS: DJE DHE SOT

Biblioteka e Suharekës ka luajtur një rol të rëndësishëm kulturor që nga fillimi i viteve '50 të shekullit XX, kohë kur edhe u themelua si institucion. Në fillimet e saj vepronte në kuadër të Shtëpisë së Kulturës dhe kishte degë në shtatë fshatra: Reshtan, Studençan, Samadraxhë, Nishor, Mushtisht, Bukosh dhe Mohlan.

Gjatë luftës së fundit, bibliotekat pësuan shkatërrime të mëdha. Bibliotekat në Reshtan, Samadraxhë, Studençan dhe Bukosh u dogjën dhe u rrënuan, duke u shkatërruar dhjetëra mijëra libra dhe duke u dëmtuar e humbur inventari bibliotekar. Në këto rrethana tragjike u vra edhe bibliotekari Hysen Kabashi. Pas luftës, veprimtarinë e vazhduan vetëm Biblioteka e Qytetit dhe dy degë: ajo e Nishorit dhe e Mohlanit. Në procesin e rindërtimit ndihmuan organizata ndërkombëtare si GTZ gjermane dhe OSBE.

Në mesin e tetorit të vitit 2001, ndërtesa e Shtëpisë së Kulturës, ku ishte e vendosur biblioteka, u përfshi nga zjarri. Sipas rrëfimit dhe shënimeve të ish-menaxheres së bibliotekës, tashmë në pension, Tahire Elshani, "falë angazhimit të jashtëzakonshëm të punonjësve dhe stafit komunal, u arrit të shpëtohen 8.570

ekzemplarë nga gjithsej rreth 22.000 libra"

Pas kësaj, Biblioteka u vendos fillimisht në një objekt provizor në oborrin e shkollës "7 Marsi", për t'u zhvendosur më vonë në një lokal afër sheshit që sot mban emrin "Fadil Vata". Këto hapësira nuk ofronin kushte të përshtatshme për punë; mungonin sallat e leximit dhe inventari i nevojshëm.

Që nga janari i vitit 2016, Biblioteka funksionon në objektin e ri në Rr. "Xhavit Bajraktari", i cili plotëson standardet e nevojshme të punës dhe ofron hapësira të mjaftueshme për lexuesit dhe stafin. Me vendimin nr. 01-Nr-020-11840 të datës 24.03.2017, të miratuar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, institucioni mban me krenari emrin e veprimtarit dhe profesorit universitar Hajdin Berisha, i vrarë gjatë luftës së fundit.

Biblioteka "Hajdin Berisha" është pjesë përbërëse e rrjetit kombëtar dhe ndërkomunal bibliotekar të Kosovës. Veprimtarinë e zhvillon nën mbikëqyrjen administrative të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Mërgatës, si dhe nën mbikëqyrjen profesionale të Bibliotekës Universitare të Kosovës dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Statuti i Bibliotekës së Qytetit "Hajdin Berisha" thekson veprimtarinë e këtij institucioni:

- Grumbullon materiale bibliotekare të formateve të ndryshme nga të gjitha shkencat e dijes, i regjistron, përpunon, sistemon, ruan, mirëmban dhe i jep në shërbim të përdoruesve.



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë

- Koordinon dhe mbikëqyr punën profesionale të bibliotekave shkollore në rajonin e vet, duke ndihmuar pasurimin e fondeve me koleksione bibliotekare.
- Ofron qasje në materialin bibliotekar për të gjithë përdoruesit, pavarësisht racës, kombësisë, gjinisë, moshës, besimit fetar, gjuhës apo paaftësive fizike; informon dhe ndihmon ata në përdorimin dhe gjetjen e tyre.
- Organizon aktivitete kulturore dhe edukative në ambientet e saj si: ekspozita libri, promovime, tribuna, takime me krijues, orë letrare dhe veprimtari të tjera bibliotekare.
- Kryen huazimin dhe këmbimin e materialeve bibliotekare për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e përdoruesve.
- Bashkëpunon me institucionet kulturore, shtëpitë botuese, shkollat dhe komunitetin me qëllim të nxitjes së interesimit për librin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Harton dhe propozon projekte e programe për zhvillimin e rrjetit bibliotekar të bibliotekave që mbikëqyr.
- Bashkëpunon me bibliotekat në vend dhe jashtë vendit me mbështetje të DKRSM-së dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Sot, biblioteka disponon një fond prej 29.750 ekzemplarësh dhe është e organizuar në disa sektorë: sektori i të rriturve, sektori i fëmijëve, sallat e leximit (të hapura dhe të mbyllura), këndi i vendlindjes si dhe sektori i pasurimit dhe përpilimit të librit.

Gjatë këtij viti janë regjistruar rreth 427 lexues në sektorin e të rriturve dhe rreth 900 në sektorin e fëmijëve. Sallat e leximit janë shfrytëzuar nga një numër i madh nxënësish, studentësh dhe profesionistësh të profileve të ndryshme. Librat më të kërkuar ishin Prilli i Thyer i Ismail Kadaresë dhe seria Ditari i Gregut e autorit Jeff Kinney.

Me iniciativë të Drejtoreshës për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, znj. Albulena Kokollari dhe me përkrahje të Kryetarit të Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, për herë të parë më 23 gusht 2025 u shënua Dita e Bibliotekës, datë që përkon me ditëlindjen e Hajdin Berishës. Kjo ditë do të shënohet tradicionalisht çdo vit.

Me qëllim nxitjen e leximit dhe forcimin e bashkëpunimit kulturor, nga shtatori i këtij viti, me nismën e udhëheqëses Arbenitë Hoxha Ramaj dhe stafit të bibliotekës, janë formuar klubet e leximit: "Zgjimi" për të rritur dhe "Bota e leximit" për fëmijë.

Biblioteka "Hajdin Berisha" sot përfaqëson një institucion të qëndrueshëm, të hapur dhe të përkushtuar ndaj dijes dhe komunitetit. Një ndër synimet kryesore të së ardhmes mbetet pasurimi i vazhdueshëm i fondit librar me tituj bashkëkohorë, literaturë shkencore dhe botime për fëmijë e të rinj, në mënyrë që Biblioteka të vazhdojë t'u përgjigjet nevojave në rritje të lexuesve dhe të forcojë misionin e saj në shërbim të dijes dhe kulturës.

Mersel Bytyçi



RËNDËSIA E LIBRIT TË SHTYPUR

Në epokën e teknologjisë digjitale, ku informacioni qarkullon me shpejtësi marramendëse dhe librat elektronikë po marrin gjithnjë e më shumë hapësirë, libri i shtypur vazhdon të mbetet një shtyllë e pazëvendësueshme e kulturës dhe dijes njerëzore.

A po i vjen fundi “erës së Gutenbergut”? Kjo është një dilemë më vete në këtë kohë zhvillimi teknologjik, ku e-book-u po ofron komoditet, shpejtësi dhe akses të lehtë; megjithatë, rëndësia e librit fizik mbetet shumë e madhe. Trashëgimia e krijuar nga libri i shtypur ndër shekuj dhe përvoja e leximit të tij vetëm sa e shtojnë peshën e tij kulturore.

Së pari, libri i shtypur bart një vlerë të veçantë kulturore dhe historike. Për shekuj me radhë ai ka qenë mjete kryesor i ruajtjes dhe përhapjes së dijes. Bibliotekat, arkivat dhe institucionet arsimore i kanë ruajtur gjithmonë librat fizikë si dëshmi të historisë dhe të zhvillimit intelektual të njerëzimit.

Përvoja e leximit në letër është më e thellë dhe më e qëndrueshme sesa ajo në ekran. Sipas studiuesve, leximi i librave fizikë përmirëson përqendrimin, kujtesën dhe kuptimin e tekstit. Letra nuk të shpërqendron; ajo të fton të ndalesh, të reflektosh dhe të hysh në botën e autorit. Kthimi i faqeve dhe shënimet anësore krijojnë një lidhje të drejtpërdrejtë me tekstin.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është ndjenja e pronësisë dhe vlera emocionale që shkakton libri. Libri i shtypur nuk është thjesht tekst; ai është një objekt që e mban në dorë, e vendos në raft dhe e ruan si gjënë më të shtrenjtë.

Ashtu si sot njerëzit komunikojnë përmes platformave elektronike—si Viber, Messenger apo biseda online—ku mund ta shohësh fytyrën e prindit, vëllait apo të dashurit, por nuk mund ta përqafosh, as t’ia ndiesh aromën, as të përjetosh ngrohtësinë e pranisë së tij; po kështu është edhe dallimi mes librit elektronik dhe librit të shtypur.

Libri elektronik ta jep tekstin, por jo ndjesinë. Ndërsa libri fizik është si një përqaftim i vërtetë: i prekshëm, i ngrohtë dhe i paharrueshëm.

Libri i shtypur ka rëndësi të veçantë edhe për nxënësit dhe studentët, në edukimin e tyre—mision që e ka kryer gjithmonë që nga “era e Gutenbergut” dhe do ta kryejë në vazhdimësi.

Letra bart në vetvete histori; në të është shkruar e kaluara e shoqërisë njerëzore.

Libri i shtypur është një urë lidhëse mes të kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes. Edhe sot, ai mbetet një dritare e sigurt e dijes dhe e pjekurisë së një shoqërie.

Prof. Ali Kabashaj



POEZIA NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT "HAJDIN BERISHA"

MENDJA E NDRITUR NË HESHTJEN E LIBRAVE

*Shkurtesa Kolgeci
IAAP "Abdyl Ramaj"*

Në raftat e qetë ndodhet një shkëndijë
Sa hap një libër nxirret shumë magji,
Faqet e vjetra fshehin misteri
Çdo fletë bart nga një histori.

Kur bota përjashta bërtet me zë
E padrejtësitë janë mbi qdo gjë
Ajo hap dyert si krahë të butë,
Të thotë eja lexo dhe gjej një rrugë!

Një fjalë e shkruar ndryshon çdo mendim
Secili varg një tjetër mësim
Duke na quar drejt së vërtetës
Për në realitetin e hidhur të jetës.

Aty hapen dyert e fshehta
Secili libër ruan rëndësitë e veta
Çdo rresht një pjesë për udhëtim
Drejt një bote plot ndriqim.

Biblioteka është vendi për mendjet e
ndritura
Ku tërë idetë shkojnë tek e papritura,
Aty ku fjalët krijojnë mrekulli
Dhe mendjen e ushqejnë me plot njohuri.

IKJE NGA KOSOVA

Gani . S. Pllana

Rinia e hamendur
E pavendosur për ardhmëri
Të rehat bredhin rrugëve
Sa zi e neveri...!

Sa vështirë qenka për ne
Kah fundi i jetës
Fëmijët t'i shohësh duke mërguar
Me zemra përvëlur!

"Edhe ti o djali im
Do të ikësh në mërgim...?
" Dua të ikë" - më tha djali
As i fundit e as i pari!

Përse o biri im?
-" Nuk po mund t'jetoj këtu...
Për hir të fëmijëve largohem
Të më falë e imja tokë
Nuk po gjej punë as shërim

Më kanë ikur dhe shumë shokë...!"
-E çuditshme kjo botë!

Vështirë o bir për ta menduar
Ikjen nga vendlindja në lule të jetës
Lotët në mjekër më janë rënduar
Pa qenë afër të vërtetës!

Babin e kaploi mërzia
O bobo ç'na gjeti



QUHET ATDHE KU NUK KE FOLE

Mazllum Baraliu

A quhet atdhe
Ku s' ke fole?!

A quhet shtet
Ku s'ka zhvillim e bereqet?!

A quhet arbëri
Ku s'ka as - as liri?

A quhet vllazëri
Ku s ka barazi?

Nuk quhet as vilajet
Ku s'ka prosperitet

Ku s'ka drejtësi
As imunitet

Ku s'ka siguri
As liri lëvizje

Ku si brenda
Dhe jashtë

Gëzimi digjet
Sikur kashtë
Si është e mundur
Në këtë shqiptari,
Të mos e gëzojm
Fuqishëm- këtë
Të shejtën - Liri

Një atdhe
Pa fole
Mund t'jetë
Një shtëllung në re.

Por jo dhe hambar
I mirë e i mbarë
Me veprimtar
Të fortë, të gjallë
Dhe me atdhetarë...?!

Mirëpo, Atdheu
Edhe po t'dënoj,
Secili nga ne
Duhet ta mbroj...!

DASHURIA E NËNES

Aurora Guri

Ti më dhurove dashurinë,
Ti më dhurove lumturinë,
Ti më dhurove jetën,
Ti më dhurove zemrën.
Ah, nëna ime e dashur,
Sa shumë që të dua.
Kur më buzëqesh ti,
ndihem e bekuar.
Ti më dhe motrën,
Ti më dhe botën,
Ti më edukove,
Ti më mësove.
Me këshillat e tua,
u bëra nxënëse shembullore

KONGRESI I MANASTIRIT

Sherife Thaqi

Kongresi i Manastirit, bëri historinë,
Filloi punët me 14 Nëntor 1908,
Shkronjat formohen për ardhmërinë,
Nga këtu këthjelli njerëzinë,
Tani u bënë 117-vjetë.

Aty u vulosën 36 shkronjat e arta,
Nga të cilat krijohen fjalë e fjali,
Në zemrat tona japin miliona gufime të zjarra,
Kuvend i Manastirit, shenjëtor në histori.

36 Shkronjat, janë dega ime e Fisit të parë,
Me to, të gjallët gjallërojnë,
Me to shkruhet krenaria e Plisit të Bardhë,
Të vdekurit i bëjmë të pa-vdekshëm përgjithëmonë.

Folenë e kanë në Manastir,
Aty hedhin valle dorë për dorë,
Sot Alfabeti ynë është më i mirë,
36 shkronjat që shkëlqejnë si Meteor.



SHËTITJE NË MARASH

Mirvete Kabashi – Leku

Vjeshta vjen ngadalë,
me qilim shumëngjyrësh.
Lumi flet me gurët e vet,
si kitarë që kujtimet i këndon.

Një peng i vjetër
lëkundet në kujtesën e kohës
së ikur.

Drejt Marashit hedh hapin,
matanë lumit më presin
hije dashurie e puthje rinie,
që më marrin përdore.

Ndalem te Rrapi Plak.
Mbi lëkurën e rrudhur
lexoj data e emra.

Kërkoj ato dy shkronja,
që dikur me dashurinë e shpirtit
i patëm gdhendur si betim.

Si Vrapuesja e Prizrenit
shtegtoj ndër vite.

Bisedoj në heshtje
me Hamletin modern,
që s'e di kah ta mbajë zemrën.

Lumi rrjedh në qetësi,
por valët e shpirtit tim
dallgëzojnë brigjet e së kaluarës
për moshën e rinisë,
që s'njihte faj e trishtim.

Stinë vjeshte shumë ngjyrëshe,
me erë e furtunë,
që s'e lëkundin muzën time.

Në sytë e mi çdo herë
lulëzon pranvera,
e në shpirt
dashuria e
përjetshme!

TEMPULLI EPIK I DIJES-MUZE

Naxhije Doçi

Në Therandën me histori krenarie në ballë,
dhe me lashtësi të renditura palë-palë
nëpër shkallët e jetës
është edhe ndërtesa e vjetër dykateshe
e shkollës fillore,
tempull epik i dijes si shenjtëri
jehut të pamposhtur në histori.
Në të me flakërimë agmie për ardhmërinë,
edhe nën trysnitë e kohëve me errësirë,
u kaliten me arsimim krejt rrëzëllim
dhe me dituri të etura prore
gjenerata të tëra shkollore.
Ndërtesë e ruajtur nga dhembja e kohës
si një mrekulli
ne fillimin e dhjetëvjetëshit e dytë të Kosovës në liri
nga plisbardhët flamurshkabë në ball
të Therandës strall me përkushtimin zemërzjarr,
renovuar e përritë me shumë dashuri e mjeshtëri.
Në fillim planifikuar si projekt nismëtar
e më vonë realizuar me vendosmërinë rrufe
për ta shndërruar në muze.

Në këtë tempull diturie
me radhitje motesh të shumta mbi te
i krevat dhe vetë katër klasët e shkollës fillore,
dy vitet e para
me mësuesen flamurshkabë, Luçie Nikolla
e dy vitet në vazhdim të mësuesja Lejtore.
Këta emra qëndrojnë përherë në mbamendjen time
si jehonë motesh
që nga koha e pafajësisë sime fëmijërore.
Me haperimin e buzëqeshur të kohës së re
shkolla e vjetër dykateshe fillore
e moshës time fëmijërore
me renovimet krejt bukuri në vërtetim syri,
e në brendi muresh
me dëshifime faktesh për lashtësi e histori
është e shpallur ndërtesë muze,
krenari për ne.



FËMIJËRIA QË RRIHTE NË XHEPAT E MI

Dea Selimi

IAAP "Abdyl Ramaj"

Ndonjëherë, kur mbyll derën ngadalë,
më duket sikur e pengoj një hije të vogël
që vrapon pas meje –
hija ime e dikurshme,
me gjunjë të gërvishtur
dhe duar të pluhurosura me lojë.

Ajo nuk më flet.

Veç ma tund një lodër të prishur,
atë që e hodha dikur në plehra
kur mendova se jam "rritur".

Sikur të më thotë:

S'e kam harruar, pse e harrove ti?"

Nuk ka aromë buke a rrapitje barishtesh kjo
kujtesë,

as oborr, as lumë, as gjysh.

Ka vetëm atë çastin kur u ula në prag
dhe kuptova se askush s'më thërriste më
jashtë.

Heshtja ishte një kambanë e vogël

që vazhdon të më bjerë në xhep

sa herë kërkoj çelësat.

Dhe unë e di:

nuk është mall për lodrat,

as për vitet,

por për versionin tim të vogël, që besonte se
bota do të zgjatej po aq sa një pasdite loje.

Dhe ndoshta ende zgjatet – veçse tani nuk di
ku të vrapoj.

Ç'EMËR KA PLAGA IME

Mirishahe Elshani

Ëndrrat nuk më lënë
rahat për derisa plaga
të shërohet
Për derisa hienat
të largohen
E shkatërroam vetë
fuqinë para perëndisë
Prandaj dielli e ka fshehur
fytyrën brenda
reve të hirta

Çdo ditë po përpiqem
të hyjë brenda tyre
Për ta shpëtuar dritën
Shpesh herë kam
kënduar e krisur
Për tokën time të ndarë
Me sytë e vërbuar e
kam parë bukurinë
Me plagë shpirti
e kam dashur lirinë
Me një fund plot dritë
Me një fund plot shpresë
Ëndrrat nuk më lënë
rahat as sot

Ç'emër ka plaga ime

Ç'emër ka dhimbja ime

Ç' fytyrë ka atdheu sot

Unë mbeta gjallë se gjallë

Por me zemër e shpirt të ndarë

Dua të fluturoj me flatrat e shqiponjës

Me flamur drejt Vlorës.



RRUGËS SË ZEMRËS

ERONA KABASHI
"IAAP SKËNDER LUARASI"

Në dritën e mëngjesit zgjohem ngadalë,
me shpresën që zemra s'e lë të bjerë fjalë.
Dita më flet me zë të qetë,
"Çdo sfidë kalohet, mjafton të jesh vetë."
Hapat e mi mbi udhë të gjatë,
mbajnë kujtime që s'i kam harruar gjatë.
Ca më kanë djegur, ca më kanë rritur,
por çdo plagë më ka forcuar shpirtin e brishtë të
ngritur.
Në botën që ndryshon pa pushim,
njeriu kërkon një fije drite, një grimë qetësim.
Një fjalë të mirë, një prekje të lehtë,
për t'i thënë vetes "edhe sot ia dola vetë."
Se jeta s'është veç gëzim e hare,
ka stuhi, lot e netë pa gjumë pa fe.
Por pas çdo nate lind një agim,
që sjell përgjigje për çdo dyshim.
Dhe unë kuptoj, me çdo rrahje të zemrës,
se forca s'vjen nga madhështia e botës.
Vjen nga guximi për t'u ngritur prap',
pasi rrëzohem e lodhem në këtë udhë të gjatë.
Prandaj ec përpara, pa frikë, pa humbur,
se rruga ime s'është kurrë e mbyllur.
Sa kohë që zemra rreh brenda me zjarr,
do gjej gjithmonë një arsye të ec më larg.

DËSHMITARË TË DHIMBJES

Antika Elshani

Me plagë në shpirt,
e lot në sy
Gjak i skalitur në gurë,
Shpirt i etur për kurë,
Plagë të vrazhda nën lëkurë.
Dëshmitarë të dhimbjes mbeten
populli ynë,
Simbol emrin e tyre në flamur.
Nën hije të errëta,
tregim i përjetshëm,
Me kokën e Shqiponjës në zemër,
Në hartë, po i njëjti emër.
Testament i fshehur me një këngë
shprese!
Metaforë e dhimbjes nën yjet e natës,
Çdo lot i kthyer,
Tani në teh të shpatës!

Gëzimi që nuk harrohet
Më 28 Nëntor Ismail Qemali,
Ngriti flamurin në Vlorë.
Marigona qëndisi flamurin kuqezi,
E trimat luftuan për një Shqipëri.

Luigj GuraKuçi, Shpend Dragobia,
Më 28 Nëntor lindi pavarësia.
Le të shkruhet në zemrat tona,
Se në çdo vend fluturon shqiponja.

Kur erdhi dita të festojmë,
Po ashtu edhe mëmëdhenë ta
nderojmë,
Nënat e trimave që ishin befasuar,
Por erdhi liria e merituar



MIDIS LIBRAVE DHE JETËS

INTERVISTA

Intervistë me shkrimtarin Ramdan Reshitaj

Ramadan Reshitaj, i lindur në Samadraxhë të Suharekës, është një prej emrave të njohur të gazetarisë dhe krijimtarisë letrare shqiptare. Arsimin fillor e kreu në vendlindje, gjimnazin në Suharekë, Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren, ndërsa studimet universitare në Prishtinë.

Karrierën profesionale e nisi si gazetar në Radio Prishtina, për të vazhduar më pas si redaktor në gazetën "Ballkani" dhe si gazetar-redaktor në të përditshmen "Rilindja". Në vitin 1992 emigroi në Suedi, ku për më shumë se një dekadë ishte kryeredaktor i revistës për informim dhe kulturë "Besa", e cila shpërndahej në mbarë Skandinavinë dhe në disa shtete të tjera të botës.

Deri më sot ka botuar 13 libra të zhanreve të ndryshme dhe mbetet një zë aktiv në fushën e letërsisë dhe gazetarisë. Ai është gjithashtu anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

1. Kur keni filluar të shkruani dhe cili ka qenë momenti kur e kuptuat se shkrimi është rruga juaj?





Nuk më kujtohet saktësisht kur kam filluar të merrem me shkrime. Por e mbaj mend si sot kur e kam shkruar vjershën e parë. Kam qenë në klasën e pestë të shkollës fillore. Në revistën e fëmijëve "Pionieri" kam botuar vjershën tri strofëshe "Lumi". Pastaj si gjimnazist në Suharekë kam shkruar artikuj nëpër gazeta si në "Rilindja", në "Flaka e vëllazërimit" në "Zërin e rinisë", etj. Që atëherë jam përcaktuar të bëhem gazetar. Si 21 vjeçar jam punësuar gazetar në Radio Prishtina.

2. Cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat përballeni si shkrimtar?

Krijimtaria letrare është si të thuash një pune vullnetare. Me fjalë të tjera është vullneti dhe dëshira që mendimet dhe preokupimet tua t'i hedhësh në letër. Nuk të detyron askush të shkruash. Natyrisht kur kryen një punë ke dëshirë që ajo të pëlqehet nga të tjerët. Kështu është edhe me letërsinë. Por në kohën që po jetojmë kanë ndryshuar gjërat. Është zhvilluar teknologjia. Epoka e internetit, e kompjuterit, e celularit iu merr shume kohë njerëzve. Aktualisht ka pak lexues. Mendoj se kjo gjendje është sfida më e madhe e shkrimtarit, pra plasmani i librit. Në anën tjetër është mirë që është rritur numri i atyre që merren me krijimtari letrare, por është jo e shëndetshme se po shmangen kriteret, se po botohen libra nga shumëkush, shpeshherë edhe pa kurrfarë vlere.

3. Çfarë iu frymëzon për të shkruar?

Njerëzit, jeta, fenomenet e ndryshme si dashuria e urrejtja në përgjithësi. I dua shumë fëmijët, nipat, mbesat. Si krijues në mërgim frymëzimin e gjej edhe tek dashuria për atdheun, për familjen dhe sfidat me të cilat përballlet çdo ditë mërgimtari.

4. Si lindi ideja për veprën tuaj "Hanifja" dhe cili është mesazhi i librit?

Romanin "Hanifja" kam filluar ta shkruaj kur isha në klasën e dytë të gjimnazit, dmth kur kisha veç



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë

17 vjet. E nisa si një rrëfim të gjatë, si një novelë. Atëherë shumë vajza e djem fejojeshin dhe martoheshin në moshë të re dhe pa dëshirë. Kishte raste kur gocat ndaloreshin nga shkolla, shtypeshin si pasojë e zakoneve prapanike, binin pre e ndërmjetësuesve matrapazë të ndryshëm dhe nuk guxonin të kundërshtonin fjalën e baballarëve. Ndonëse edhe në atë kohë kishte dashuri zemrash si ishte rasti i kryepersonazhëve të romanit, Nifës e Tafës.

Fatbardhësisht ato kohë kanë përfunduar. Romani "Hanifja" mban vulën e kohës dhe se mesazhi i tij është se përkundër të gjithave dashuria e vërtetë çdo herë do të triumfojë.

5. Si e shihni rolin e bibliotekës në zhvillimin kulturor dhe letrar?

Mendoj se biblioteka është institucion me rëndësi të veçantë në zhvillimin mendor dhe social të shoqërisë në përgjithësi dhe të individit në veçanti. Sado që teknologjia ka arritur majat më të larta dhe që njeriut ia ka shkurtuar rrugën dhe kohën për të ardhur më shpejt dhe më lehtë deri te informacionet e nevojshme, materialin e shkruar në letër, konkretisht librin, nuk mund ta zëvendësojë asgjë. Tash kemi një rrjet mjaft të përhapur të bibliotekave bashkëkohore, me lokale të mjaftueshme, me kushte për lexim dhe studim. Dhe kjo është e mirë për zhvillimin e individit dhe të shoqërisë. Uroj që bibliotekat të jenë plotë me lexues.

6. Cilat janë këshillat për të rinjtë që duan të shkruajnë por hezitojnë të hedhin hapin e parë?

Pikë së pari ata që dëshirojnë të merren me krijimtari letrare duhet të jenë dashamirë të librit. Duhet të lexojnë shumë. Sa më tepër që i lexojnë veprat e të tjerëve aq më shumë do të pasurohen me dije dhe do të aftësohen për të shkruar. Leximi është dhurata më e mirë për atë që përcaktohet për të shkruar. Tjetra që është shumë me rëndësi është guximi për të hedhur në letër atë që na preokupon. Kurrë nuk duhet menduar se çka do të thonë të tjerët për tregimin ose vjershën tënde. Në fillim mjafton që ajo që ke shkruar të të pëlqej ty. Bëhu i guximshëm për të shkarkuar ngarkesat e trurit tënd dhe të njëjtat për ti vendosur në letër. Ushtrohu për të shkruar shkurt, çart dhe me domethënie. Mësohu nga shkrimtarët tjerë!



Intervistë me mësimdhënësen Myrvete Zenelaj

Myrvete Zenelaj ka lindur më 1 gusht 1946 në qytetin e Vushtrrisë. Shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në vendlindje, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike – Dega Gjuhë dhe Letërsi – e ka përfunduar në Prizren. Ajo ka punuar dy vjet si mësuese e gjuhës në Vushtrri, e më pas në shkollën fillore “7 Marsi” në Suharekë deri në pensionim.

Gjatë gjithë karrierës së saj është dalluar për përkushtim, dashuri dhe përgjegjësi në punë, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin gjuhësor, letrar dhe komunikues të shumë gjeneratave të nxënësve. Leximi ka qenë pasioni i saj që nga fëmijëria dhe vazhdon të mbetet i tillë edhe sot. Ajo është lexuesja më e vjetër në moshë e bibliotekës sonë.

Në shenjë mirënjohjeje, Biblioteka e Qytetit ia ka ndarë çmimin “Lexuesi Veteran” në gusht të këtij vit.

1. Sa vite keni që vizitoni Bibliotekën e Suharekës dhe çfarë do të thotë kjo hapësirë për ju?

Bibliotekën e Suharekës e kam vizituar qysh nga viti 1971. Hapësira e saj do të thotë një strehë e qetë në mes të zhurmës së botës.



ZGJIMI- Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë

2. Çfarë e motivon një zonjë mbi 80 vjeç të vazhdojë të lexojë çdo ditë?

Edhe pse kam 80 vjet, libri vazhdon të jetë shoqëruesi im më i miri. Më motivon dëshira për të mbajtur mendjen të gjallë, zbuloj botë të reja dhe të mos ndalem së lexuri. Librat më japin qetësi, gëzim dhe më mbajnë lidhur me jetën.

3. Sa libra i keni lexuar deri më tani?

Kam lexuar një numër të madh të librave, prandaj nuk muj me definuar numrin e tyre.

4. Çfarë roli ka pasur leximi në jetën tuaj profesionale, në familje dhe në përditshmëri?

Leximi ka qenë shtylla kryesore e jetës sime, si në profesion, ashtu edhe në familje dhe në përditshmëri. Si arsimtare libri ka qenë mjete im më i përdorshëm, përgatitesha për orët e mësimi, kërkoja mënyra të reja për t'ua afruar nxënësve dashuri për dije. Në familje, leximi ka krijuar një atmosferë ngrohtësie dhe kulture. Fëmijëve të mi gjithmonë u kam mësuar që libri është një dritare e hapur drejt jetës. Në përditshmërinë, leximi më jep qetësi, më pasuron shpirtin.

5. Çfarë mesazhi do t'u jepnit të rinjve për të mos e braktisur librin?

Të rinjve dua t'u them një gjë nga zemra: mos e braktisni librin! Kur lexoni, nuk epasuroni vetëm mendjen, por edhe karakterin. Libri ju jep fjalë, ju jep imagjinatë, ju jep mençuri. Në këtë botë të shpejtë, leximi është thesar. Të lexosh do të thotë të dialektoshë me një njeri të urtë.



KOHA PËR LEXIM

REKOMANDIMET E LIBRAVE




Roman që ndërthur dy periudha kohore- atë të revolucionit rus dhe kohën moderne. Dukeshës Tatiana Romanov dhe një ushtari, e cila mbetet e fshehtë për dekada. Një grua në ditët tona zbulon të kaluarën e saj misterioze, duke lidhur fatet e dy grave të ndara nga koha, por të bashkuar nga dashuria dhe sekretet.




Libri tregon historinë prekëse të Tequilës Leila, një gruaje turke e vrarë, e cila për dhjetë minuta pas vdekjes kujton jetën e saj. Gjatë atyre minutave, ajo rikthen kujtimet e dashurisë, dhimbjes dhe miqësisë në Stambollin e ashpër e të bukur njëkohësisht. Romani është një reflektim i thellë mbi dinjetitin njerëzor, shoqërinë dhe fuqinë e miqësisë përtej vdekjes.



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë



Një vepër e jashtëzakonshme që eksploron historinë, kulturën dhe konfliktet në rajonin Ballkanit në fillim të shekullit të XX-të. Libri përshkruan jo vetëm sfidat dhe vështirësitë e popujve të Ballkanit, por edhe pasurinë e kulturës dhe shpirtin e tyre të pathyeshëm. Durham përshkruan male, fshatra, qytete dhe popuj të ndryshëm: kulturat, zakonet, besimet e tyre, por edhe varfërinë, vuajtjet dhe tensionet politike që ekzistojnë.



Roman filozofik që ndjek udhëtimin shpirtëror të një të riu indian, i cili largohet nga shtëpia për të gjetur kuptimin e jetës. Ai provon asketizmin, jetën e kënaqësive, pasurinë dhe dashurinë, por asgjë nuk i jep paqe. Vetëm pranë lumit, duke dëgjuar zërin e natyrës dhe duke pranuar jetën ashtu si është, Siddhartha arrin iluminimin. Libri është një reflektim i thellë mbi kërkimin e vetvetes, dashurinë, përvojën personale dhe rrugën drejt qetësisë së brendshme.



Një roman klasik që tregon historinë e Elizabeth Bennet, një vajzë e zgjuar dhe e pavarur, dhe zotëri Darcy-t, një aristokrat i rezervuar dhe krenar. Në fillim, të dy gjykojnë njëri-tjetrin sipas paragjytimeve dhe krenarisë, por me kalimin e kohës kuptojnë gabimet, rriten shpirtërisht dhe mësojnë të shohin përtej dukjes. Romani është një histori dashurie, por edhe një kritikë elegante e shoqërisë, klasave dhe mendësive të kohës.



Një hulumtim zhbirues dhe largpamës në problemet më të nxehta të ditëve të sotme, ndërkohë që lëvizim drejt hapësirave të panjohura të së ardhmes. Teksa teknologjia përparon më shpejt sesa vetë ndërgjegjësimi ynë rreth saj, pirateria informatike kthehet në një taktikë luftarake dhe bota ndihet më e polarizuar se kurrë, Harari na njeh me sfidat e rrjedhës së jetës në përballjen me ndryshimin constant dhe të pa orinetuar dhe shtron pyetje të rëndësishme ekzistencialiste që secili prej nesh duhet t'i bëjë vetes për të siguruar mbijetesën.



Ky libër është vëllim përvojash i Eëesley K. Clark, gjenerali i NATO-s, gjatë luftërave në Ballkan (sidomos Kosova) në vitin 1999. Clark përshkruan se si lufta moderne (sipas tij) ka ndryshuar: nuk është më për marrje territori, por për të detyruar armikun të pranojë kushte specifike, me sulme ajrore të përqendruara dhe strategji precize. Ai tregon vështirësitë e komandimit ushtarak nën koalicionin e NATO-s: puna me 19 vende, interesat që ndryshojnë, diplomaci brenda dhe jashtë fushës së betejë.

Nacionalizmi Shqiptar” e trajton nacionalizmin prej këndvështrimi kritik e akademik — jo mitik, jo propagandistik.

Libri ofron analizë historike të zhvillimeve politike e sociale që kanë ndikuar në formësimin e identitetit shqiptar dhe në rrugët e ndryshme që ky identitet mori me kohë.

Është një vepër e rekomanduar për studiues, studentë, politikanë dhe të gjithë ata që duan të kuptojnë më mirë rrugëtimin kombëtar të shqiptarëve dhe sfidat e nacionalizmit në kontekstin modern.



Një analizë studimore për lëvizjen që ndryshoi historinë e Kosovës

Libri *Revolucioni 1981* i Prof. Dr. Bajram Kosumi është një studim i hollësishëm dhe multidimensional mbi demonstratat e vitit 1981 në Kosovë. Gjatë leximit të librit, kuptohet se qasja e autorit bazohet në dy aspekte themelore: njohjen dhe kuptimin e saktë të procesit politik dhe social të asaj kohe, si dhe përcaktimin terminologjik mbi këto ngjarje, duke e titulluar librin monografik për demonstratat e vitit 1981, *Revolucioni 1981*.




Ky libër është shumë domethënës dhe plotë me aventura. Këtu, bëhet fjalë për disa djem guximtar, të cilët vendosin të shkonin tek një shpellë, e cila njihet me emrin "Shpella e Piratëve". Aty, djemtë ndeshen me shumë situata, por i kalojnë pa problem pasi që punuan së bashku për të përfunduar çdo sfidë pa as edhe një vështirësi.


ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë



Ky libër është shumë domethënës dhe plotë me aventura. Këtu, bëhet fjalë për disa djem guximtar, të cilët vendosin të shkonin tek një shpellë, e cila njihet me emrin “Shpella e Piratëve”. Aty, djemtë ndeshen me shumë situata, por i kalojnë pa problem pasi që punuan së bashku për të përfunduar çdo sfidë pa



Romani “Robinson Kruzo”, i botuar në 1719, është një nga veprat e para të prozës realiste dhe mbetet një nga librat më të lexuar në bote. Në libër shihet forca e njeriut për t’u përshtatur, për të punuar dhe për të mos u dorëzuar, edhe kur është krejt i vetëm. Robinsoni ndërton strehë, gjen ushqim, mëson t’i krijojë gjërat vetë dhe mbijeton vetëm me vullnet dhe këmbëngulje. Më vonë, marrëdhënia e tij me Të Premten tregon nevojën e njeriut për shoqëri dhe bashkëpunim!



Poema "Bagëti e Bujqësi", botuar në 1886, është një nga veprat më të njohura të Naim Frashërit dhe një moment i rëndësishëm i Rilindjes Kombëtare. Në këtë poezi, Naimi shpreh dashurinë e tij të madhe për Shqipërinë, natyrën dhe jetën fshatare. Ai përshkruan fushat, bagëtinë, punën e bujqve dhe qetësinë e vendit të tij me shumë ngrohtësi!

Vepra është një lavdërim i thjeshtësisë dhe i harmonisë midis njeriut dhe natyrës. Naimi përdor një gjuhë të butë dhe plot ndjenjë, duke na treguar se sa e rëndësishme është puna, toka dhe lidhja shpirtërore me atdheun. Në thelb, poema i bën thirrje shqiptarëve të duan vendin e tyre dhe ta shohin bukurinë e tij të vërtetë!

Në këtë libër bëhet fjalë për një vajzë jetime e cila e kishte emrin Lule, dhe për një grua me vajzen e saj Shegën.

Lulen e morën dhe e rritën të cilën e trajtuan shumë keq. Njerka e saj gjithmonë e shfrytëzonte Lulën për të gjitha kërkesat ose nevojat që vajza e saj Shega i kërkonte, dhe gjithmonë i thoshte ti bënte të gjitha punët e shtëpisë!


Lulja kurrë nuk ja refuzoi kërkesat që njerka e saj i tha dhe Lulja kurrë nuk u lodh sepse gjithmonë thoshte se puna pa pritesë nuk të lodh por të jep vullnet.



ZGJIMI- Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë




Një princ në kërkim të kënaqësive, një gjigand egoist e të tjerë: Përrallat e Oscar Ëild, të publikuara për herë të parë në vitin 1888, për fëmijë të moshës nga tetëmbëdhjetë deri në tetëdhjetë



Është shumë e vështirë që të gjesh një fëmijë që të ketë kaluar moshën e fëmijërisë pa Tom Sojerin. Në këtë libër flitet për disa djemtë cilët janë shokë dhe kanë mërzi të mësojnë dhe të shkojnë në shkollë.



Ky roman i shkrimtarit të madh francez Zhyl Vern vë në jetë fiksionin ironik se si biznesmenët janë ata të cilët kishin marrë pjesë ushtarakisht në luftë, kishin shpikur armë dhe kishin marrë pjesë në Luftën Civile në Shtetet e Bashkuara të Amerikës por tash që kishte përfunduar lufta ishin të mërzitur dhe vendosën ta dërgonin predhën në hapësirë.



"Nita" është një histori që tregon dhimbjen, luftën dhe sakrificën e një nëne për fëmijën e saj. Përmes Ndrecës dhe Nitës, libri paraqet se si dashuria dhe besimi mbajnë gjallë njeriun edhe kur përballlet me varfëri, padrejtësi dhe fatkeqësi.



ZGJIMI- Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha"- Suharekë

LIBRI



Roman klasik i shekullit XIV, i treguar nga këndvështrimi i një kali. “Bukurosh i zi” tregon jetën e një kali që kalon nga duar të mira në duar të këqija dhe përjeton edhe dashuri, vuajtje. Përmes rrugëtimit të tij, libri jep mesazhin se kafshët ndiejnë njësojë si njerëzit, prandaj meritojnë mirësi, kujdes dhe respekt.



ZËRI I LEXUESVE

LEANDRA MAMAJ

"Leximi dhe studimi në Bibliotekën "Hajdin Berisha" në Suharekë më krijojnë një hapësirë të qetë dhe frymëzuese, ku çdo libër shndërrohet në një dritare plot ndriçim drejt dijes. Në këtë ambient të ngrohtë dhe kulturor, secili prej nesh gjen rehatinë dhe motivimin për të vazhduar studimin, duke e bërë procesin më të lehtë dhe më të këndshëm. Biblioteka është bërë shtëpia ime e dytë dhe vendi im i preferuar, ku unë kaloj kohët më të çmuara të jetës"!



BLENDI ELSHANI



"Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" është vendi ku unë lexoj më së miri. Është një ambient i qetë, i rehatshëm dhe shumë frymëzues. Përmes leximeve kam ndërtuar karrierën time, dhe kjo falë bibliotekës. Mikpritja e stafit dhe mbështetja e tyre janë edhe një arsye më shumë për të ardhur në këtë institucion"



SHPRESA MORINA

"Jam çdo ditë në Bibliotekën e Suharekës, sepse këtu gjej qetësinë, pastërtinë dhe harmoninë që ekipi juaj e ka shndërruar në një ambient ideal për t'u përqendruar dhe për të ndërtuar të ardhmen time hap pas hapi. Falë punës suaj, ky vend është bërë hapësira ime e preferuar"



ARBES BAJRAKTARI



"Për mua, biblioteka është një ambient i organizuar dhe i qetë, ku gjej kushtet ideale për t'u përqendruar dhe për të punuar me fokus. Librat janë të përzgjedhur dhe të sistemuar në mënyrë të tillë që të kem qasje të shpejtë dhe të lehtë të informacioni që më nevojitet, duke e bërë çdo vizitë të dobishme dhe produktive.

Biblioteka më ofron një hapësirë ku mund t'i zhvilloj njohuritë e mia pa shpërqendrim, gjë që ndikon pozitivisht në rritjen time profesionale dhe personale"



SHQIPRON GALLAPENI

"Arsimimi është një nevojë që shoqëron njeriun gjatë gjithë jetës, dhe rruga më e natyrshme drejt tij është leximi. Për të qenë i arsimuar duhet të jesh edhe i lexueshëm, dhe këtë e mundësojnë materialet e shumta që biblioteka "Hajdin Berisha" i vë në dispozicion të çdo vizitori.

Përveç literaturës së pasur, kjo bibliotekë ofron një mjedis të qetë e të përshtatshëm për lexim, një hapësirë që shpesh herë mungon në shtëpitë tona. Kjo e bën bibliotekën një vend të domosdoshëm për kulturën dhe zhvillimin tonë të vazhdueshëm, si në rrafshin personal ashtu edhe atë profesional."



NAZIFE SOPA



"Me Bibliotekën e Qytetit jam njohur që në fëmijëri. E kujtoj hapësirën e vogël plot aromë librash dhe punonjësit e sjellshëm që më ndihmonin të zgjidhja titujt e mi të parë. Huazimi i librave dhe kartoni i leximit ishin krenaria ime e atëhershme.

Dashuria për librat u rrit bashkë me mua. Si studente, objekti i ri i bibliotekës më ofroi hapësirën ideale për studim: qetësi, ambiente të gjera dhe qasje të përditshme, të gjitha falas. Çdo ditë merrja autobusin e parë për të ardhur këtu dhe për t'u përgatitur për provime. Jam thellësisht mirënjohëse që pata mundësi të zhvillohesha akademike në vendin tim, pa shpenzime dhe pa shqetësim."



ZANA KUÇI

"Jo në çdo vend mund të lexosh dhe të ndash përjetimet e ditës — përfshirë ato që ke lexuar — me njerëz të mirë, plot gjallëri dhe të aftë për të ofruar ide e mendime që ta ndryshojnë ditën dhe ta bëjnë edhe më të bukur. Çdo element që i ka munguar 'minibotës' sime të leximit e kam gjetur në këtë bibliotekë.

Këtu kam gjetur një hapësirë të qetë, frymëzuese dhe të mbushur me dashuri për librin."



DIELLZA BUZHALA



"Biblioteka e Qytetit për mua ka qenë si një shtëpi e dytë për shumë vite. Kur ishte në lokacionin e vjetër, në atë objektin e vogël, mikpritja dhe mirësjellja e bibliotekareve më jepnin po aq kënaqësi sa raftet e mbushura me poezi e tregime. Ndërsa në objektin e ri, me sallat e leximit, gjeta jo vetëm një vend për të lexuar e studiuar, por edhe një hapësirë ku shumë ëndrra dhe ambicie të miat morën formë. Çmimi që mora në vitin 2015 nga Biblioteka e Therandës mbetet një nder dhe një kujtim i veçantë për mua."




MIRË SE VINI NË VENDIN E MENDJEVE MË TË NDRITURA!



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë

LORESA BELULI

"Si lexuese e apasionuar, e ndiej bibliotekën si një vend të veçantë ku fjala e shkruar më mbush me qetësi dhe frymëzim. Çdo libër që gjej aty më hap një dritare të re njohurie dhe fantazie. Stafi i përzemërt dhe ambienti i ngrohtë e bëjnë kohën e kaluar në bibliotekë një kënaqësi të vërtetë. Është një vend që e dua dhe e vlerësoj thellë."





BIBLIOKLUBET

Në shtator të vitit 2025 janë krijuar dy klube të leximit. Klubi i leximit për të rritur "Zgjimi" dhe klubi i leximit për fëmijë "Bota e leximit".

Qëllimi kryesor i klubeve të leximit është të nxisin kulturën e leximit dhe të krijojnë një mjedis të përbashkët ku pjesëmarrësit mund të diskutojnë, analizojnë dhe përjetojnë më thellë librat që lexojnë. Përmes këtyre klubeve synohet të:

Inkurajojnë zakonet e rregullta të leximit tek fëmijët dhe të rriturit.

- Zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, interpretimit dhe diskutimit të ideve.
- Forcojnë kompetencat gjuhësore, si pasurimin e fjalorit dhe përmirësimin e të shprehurit.
- Krijojnë hapësira sociale dhe bashkëpunuese, ku pjesëmarrësit ndërveprojnë dhe shkëmbejnë mendime.
- Zgjojnë kreativitetin dhe imagjinatën përmes tregimeve, debatit dhe reflektimit.
- Ndhmjnë nxënësit dhe të rinjtë të zhvillojnë vetëbesimin duke prezantuar mendimet e tyre.
- Forcojnë lidhjen me bibliotekën, duke e bërë atë një pikë takimi aktive dhe të rëndësishme për komunitetin.

Anëtarët e klubit të leximit "Zgjimi" janë: Jashar Gashi, Raif Gallapeni, Milaim Gallopeni, Mersel Bytyçi, Loresa Beluli, Orgesa Zekolli, Zana Kuçi dhe Albert Morina.

Anëtarët e klubit të leximit "Bota e leximit" janë: Ajan Tahiri, Ajana Tahiri, Era Kabashi, Eliza Grulaj, Inara Grulaj, Lorena Salltekaj, Bleron Salltekaj, Ylli Berisha, Anis Aliaj, Nera Berisha, Aurora Guri dhe Valina Fetiu.



ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë



Klubi i fëmijëve "Bota e Leximit", që vepron në bibliotekën tonë, zhvillon bashkëpunim të vazhdueshëm me Klubin e Qendrës së Karrierës në Shkollën Fillore "7 Marsi" në Suharekë. Ky bashkëpunim realizohet nën përkujdesjen e këshilltares Donjeta Gashi Hajdari dhe synon nxitjen e kulturës së leximit, zhvillimin e shprehive krijuese dhe orientimin e hershëm të fëmijëve drejt dijes dhe interesave të tyre personale.





STAFI I BIBLIOTEKËS

Biblioteka e Qytetit “Hajdin Berisha” funksionon falë përkushtimit të stafit të saj. Secili zyrtar kontribuon që biblioteka të jetë jo vetëm vend i leximit, por edhe hapësirë e kulturës, dijes dhe miqësisë. Ata hapin derën çdo mëngjes, ndihmojnë lexuesit të gjejnë librin e duhur dhe ruajnë qetësinë e sallës dhe ngrohtësinë e fjalës.

Çdo buzëqeshje në sportel, çdo këshillë për një titull të ri, çdo kujdes për një faqe të vjetër libri – është pjesë e dashurisë së tyre për bibliotekën.

Falë tyre, biblioteka “Hajdin Berisha” është shumë më tepër se një hapësirë librash – është një shtëpi e dijes.



Arbenitë Hoxha Ramaj- Udhëheqëse e Bibliotekës së Qytetit “Hajdin Berisha”

ZGJIMI - Biblioteka e Qytetit "Hajdin Berisha" - Suharekë



Miradije Rraqi- Zyrtare e Bibliotekës së Qytetit "Hajdin Berisha"



Shpresa Berisha- Zyrtare e Bibliotekës së Qytetit "Hajdin Berisha"



Ramiz Selimaj- Zyrtar i Bibliotekës së Qytetit "Hajdin Berisha"



Urime Vitin e Ri 2026!

Festoni me gëzim, dritë dhe
shpresë të re në zemër.

*Biblioteka e Qytetit
“Hajdin Berisha”*

SUHAREKË

EUROING

*Falënderim i veçantë
për sponsorin e revistës Zgjimi*



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS

THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA- OPSTINE SUVA REKA
 DREJTORIA PËR KULTURË, RINI, SPORT DHE MËRGATË
BIBLIOTEKA E QYTETIT "HAJDIN BERISHA"

